

QYTETARËT PËR NDRYSHIM

TETOR-DHJETOR 2025 // CIVICAMOBILITAS.MK

BULETIN NR.23



Foto: Organizata e Grave e Komunës së Sveti Nikollës



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



PJESËMARRJA QYTETARE ËSHTË E DREJTË DHE PËRGJEGJËSI E TË GJITHËV

Në fokus të këtij numri të Qytetarët për ndryshim është pjesëmarrja qytetare. Temë, të cilën organizatat qytetare edhe në këtë tremujor, jo vetëm që diskutuan rreth asaj, por edhe praktikuan.

Kolegët nga ProLokal, nga Manastiri, këtë e bënin në nivel regional dhe lokal, në gjithë Pellagoninë. Bashkë me partnerët nga sektori dhe komunat nga regjioni, ata i përfshinë të rinjtë, propozimet dhe analiza e të cilëve kontribuan për krijimin e politikave lokale më të drejta për të gjitha nëntë komunat. “Këto zgjidhje nuk janë shkruar pas dyerve të mbyllura, por janë rezultat i një procesi ku vetë të rinjtë i alokuan problemet”, thotë Emilia Gjeroska nga “Pro Lokal”.

Aktivitetet e komuniteteve lokale dhe përfaqësueset e organizatave qytetare, të organizuara nga “Akcija Združenska” – Shkup, erdhën në Kuvend që zyrtarisht t’i prezantojnë kërkesat e tyre para te zgjedhurve të popullit. Ata kërkuan ndryshime në Ligjin për vetëqeverisje lokale me të cilat do të mundsojnë procedurë në më shumë faza për pjesëmarrje të qytetarëve, me fokus të veçantë të pjesëmarrjes së garantuar të grave.

Qendra për ndryshime klimatike e publikoi Raportin në hije për Kapitullin 27, i cili zbulon se gjendja me ambientin nuk është e cje në vend. Ata i bëjnë apel Qeverisë, Kuvendit dhe institucioneve kompetente për miratimin urgjent të ligjeve të ngecura nga Kapitulli 27 dhe sigurimin e financimit të qëndrueshëm për sektorin e ambientit dhe rekomanduan se pasojat nga pasiviteti institucional drejtpërdrejtë i ndjejnë qytetarët përmes keqësimit të shëndetit dhe degradimit të resurseve natyrore.

Si mbështetje e të gjitha iniciativave të organizatave qytetare, veçanërisht kur është në pyetje pjesëmarrja qytetare, Civika mobilitas e organizoi Forumin e dytë kombëtar – Panairi i organizatave qytetare në bashkëpunim me Qeverinë e RMV. Deklaratat e përfaqësuesve të pushtetit qendror ishin më shumë se inkurajuese për bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e organizatave qytetare. Kryeministri Mickoski e përcolli vizionin e Qeverisë për sektorin civil si partner i vërtetë, i fuqishëm, i pavarur, profesional dhe i qëndrueshëm në krijimin dhe realizimin e politikave shtetërore. “Sektor, i cili e fuqizon demokracinë, i mbron të drejtat e qytetarëve, e vëzhgon punën e institucioneve dhe ndihmon që të mbyllet hendeku mes institucioneve dhe popullit”, tha ai.

Ajo që na mbetet të gjithëve është shumë punë, me të cilën do t’i bindim skeptikët se pjesëmarrja qytetare nuk është vetëm një nga temat “e popullarizuara” të organizatave qytetare, por edhe përgjegjësi e jona si organizata qytetare dhe si qytetarë. Të jemi të vetëdijshëm se pjesëmarrja jonë në komunitet, në punë, në institucione, mund të bëjë ndryshime vetëm nëse ekzistojnë. Proceset në të cilat marrin pjesë një numër i madh i qytetarëve krijojnë politika më reale sepse përfshijnë perspektiva të ndryshme. Aktiviteti ynë e bën shoqërinë më të drejtë, më të fuqishme dhe më të qëndrueshme. Lexim të këndshëm!

Gonce Jakovleska

Koordinator kombëtar i
Civika mobilitas për IKO

Falënderojmë: Qendrën për Komunikime Qytetare (QKQ), Qendrën për Ndryshime Klimatike (QNK), Qendrën për Burime Qytetare (QBQ), Pro lokal Manastir, “Së bashku më të fuqishëm”, HERA – Asociaconi për Edukim Shëndetësor dhe Hulumentim, Organizatën e Grave në Komunën e Sveti Nikollës (OGKSN), Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (KHDNJ), Fondacionin Metamorfozis, Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), Rrjetin Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN), “Akcija Združenska”, Shoqatën Rome për Gra dhe të Rinj “Luludi”, Qendrën Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ), Promo Idea, Novus, “Proagro fermerët”, “Stacioni PET”, “Suport Koçani”, (Support Kocani), Agjencia Informativë Mediatike (MIA), portalin Racin.mk, Njësitin e Vëzhguesve “Dimitar Vllahov” dhe Departamentin për Bashkëpunim me Organizatat Joqeveritare të Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë për mbështetjen dhe aksesin në informacion në përgatitjen e teksteve për këtë numër. Arkivi i fotove: Civika mobilitas, Fondacioni “Metamorfozis”, Pro lokal, Qendra e Burimeve Qytetare, “Akcija Združenska”, NJV “Dimitar Vllahov”, Racin.mk, Promo Idea, “Novus”, Hera, SHGM, KHDNJ, “Konekt”, OGKSN, QNK, QKQ, MIA.



TEMA
**PJESËMARRJA
QYTETARE**

Rajoni i Pellagonisë i përfshin të rinjtë në vendimmarrje



Transport më i mirë publik, këshilla funksionale rinore dhe programe të reja mbështetëse ndër gjeneratash janë vetëm disa nga masat që u miratuan unanimisht në takimin e katërt të Platformës rajonale rinore në Rajonin e Pellagonisë. Ky aktivitet, i organizuar nga “Pro Lokal”, përfaqëson një hap të rëndësishëm përpara në pjesëmarrjen qytetare, ku të rinjtë marrin pjesë në krijimin e politikave lokale më të drejta për të nëntë komunat në rajon përmes propozimeve dhe analizave të drejtpërdrejta. Platforma rajonale rinore u krijua në mars të vitit 2024 dhe është një mekanizëm i përbashkët i nëntë komunave dhe organizatave të shoqërisë civile në Rajonin e Pellagonisë.

Një nga masat më inovative të miratuara është programi i mentorimit dhe mësimdhënies private nga bashkëmohatarët, i cili do të përfshijë profesorë dhe ekspertë në pension përveç studentëve. Përmes këtij modeli, të rinjtë do të marrin mbështetje falas në arsim, duke forcuar njëkohësisht solidaritetin ndër gjeneratash. Përveç kësaj, masat parashikojnë edhe hapa konkretë për transport publik më të aksesueshëm në përputhje me nevojat e studentëve, veçanërisht nga zonat rurale, si dhe përdorim më të mirë të infrastrukturës sportive dhe krijimin e hapësirave të sigurta për kohën e lirë aktive.

Ambasadori i Zvicrës, Sh.T. Kristof Somer dhe kryetari i Komunës së Manastirit, Toni Konjanovski, thanë se përfshirja e të rinjve është një parakusht për zhvillim dhe një të ardhme të qëndrueshme, dhe se këto masa duhet të përkthehen menjëherë në buxhete për të sjellë ndryshime

të vërteta. Siç theksoi Emilia Gjeroska nga “Pro Lokal”, këto zgjidhje nuk janë shkruar pas dyerve të mbyllura, por janë rezultat i një procesi në të cilin vetë të rinjtë i kanë gjetur problemet. Platforma rajonale, e cila ka zbatuar tashmë 16 iniciativa me përfshirjen e mbi 250 të rinjve, dëshmon se sektori civil është ura kryesore midis të rinjve dhe institucioneve në luftën kundër stagnimit dhe për ruajtjen e potencialit në komunitetet lokale.

Si pjesë e aktivitetit, u mbajt edhe një Forum tematik, dedikuar një debati mbi mundësitë e barabarta për të rinjtë në komuna të ndryshme. Mesazhi ishte se nuk ka të ardhme nëse Ligji për pjesëmarrjen e të rinjve mbetet vetëm një detyrim formal në letër. Gjetjet fillestare nga vlerësimi kombëtar nga “Pro Lokal” treguan se zbatimi i ligjit ndryshon në mënyrë drastike, me shumë zona më të vogla dhe rurale që ende nuk kanë qendra funksionale rinore, këshilla dhe mbështetje të qëndrueshme financiare. Forumi theksoi se organizatat e shoqërisë civile janë ura lidhëse në këto zona dhe përfshirja e të rinjve në vendimmarrje nuk duhet të shihet si një kosto, por si një investim në mbajtjen e tyre në komunitete.

Aktivitetet janë pjesë e projektit “Politikat rinore të përshtatura për të rinjtë”, i mbështetur nga Qeveria e Zvicrës përmes Civika mobilitas.



Aktivistet nga komunitetet lokale hynë për herë të parë në Parlament

Për hera e parë, aktivistet nga komunitetet lokale dhe përfaqësueset e organizatave femërore hynë në Parlament që zyrtarisht t'i paraqesin kërkesat e tyre para zë zgjedhurve të popullit. Takimi i organizuar nga “Akcia Zdruzhenska” – Shkup, u mbajt në Klubin e deputetëve, ku 16 gra nga mjedise rurale dhe tetë organizata lokale kërkuan ndryshime reale në Ligjin për vetëqeverisje lokale.

Theksi kryesor në takim ishte vendosur mbi nevojat nga ndryshimet ligjore të cilat do të mundësojnë procedurë shumëfazëshe për pjesëmarrje të qytetarëve, me fokus të veçantë të pjesëmarrjes së garantuar të grave, fuqizimin e vetëqeverisjes lokale dhe sigurimin e resurseve hapësinore dhe financiare që pjesëmarrja femërore të bëhet realiste dhe e qëndrueshme. Marija Savovska, drejtoreshë ekzekutive e “Akcia Zdruzhenska” theksoi se lidhshipi femëror dhe qasja për shërbime nuk duhet të varen nga vullneti i mirë i komunave, por kërkojnë përgjigje urgjente kombëtare.

Pas kësaj foli Lençe Hristova nga Organizata e Grave - Strumicë, duke u bërë thirrje deputeteve femra të mbështesin votimin për ndryshimet në Ligjin për vetëqeverisje lokale në seancën e 52-të plenare.

Përfaqësuesit e shoqatave lokale vunë në dukje probleme serioze strukturore. Elizabeta Stojanova nga rrethi i grave në Saçevë paralajmëroi për stereotipet e brendshme dhe institucionet e mbyllura si pengesa për përfshirje, ndërsa Fadrije Mustafovska nga “Radika-De” vlerësoi se gratë nga zonat rurale shpesh janë të padukshme për programet publike për shkak të mungesës së pronës, arsimit dhe lëvizshmërisë.

Dëshmitë për mungesën e ujit të pijshëm të sigurt ishin veçanërisht dramatike. Ivana Cvetkoviç Stojçeva nga “Nëna” Kumanovë ndau të dhëna nga Instituti i Shëndetit Publik për vitin 2024, sipas të cilave pothuajse 43% e mostrave



të ujit në fshatrat e Kumanovës janë bakteriologjikisht të dëmtuara.

“Banorët në 44 fshatra vetë gjenden me ujin, ndërsa sistemi jofunksional i kanalizimeve kërcënon drejtpërdrejt shëndetin dhe vendin”, tha ajo. Zheljka Dikliq Ilievaska nga fshati Pçinja konfirmoi se kjo është gjithashtu një barrë ekonomike, duke deklaruar se familja e saj shpenzon 40 euro në muaj vetëm për ujë të pijshëm në shishe dhe 50 euro shtesë për nevojat e familjes.

Takimi përfundoi me një apel të qartë: kërkesat e grave vendase nuk janë çështje dëshire, por të drejtave themelore të njeriut, shëndetit, sigurisë ekonomike dhe pjesëmarrjes demokratike. Organizatorët u kërkuan institucioneve të sigurojnë mekanizma dhe burime të përhershme (financiare dhe teknike) me të cilat aktivizmi i grave do të bëhet një pjesë e qëndrueshme e vendimmarrjes lokale.

Organizatrat e shoqërisë civile 12 herë më efektive në luftën kundër HIV-it

Me rastin e 1 Dhjetorit - Ditës Botërore të HIV-it, shoqatat qytetare lëshuan një thirrje alarmuese drejtuar institucioneve për diagnostikim në kohë dhe terapi të vazhdueshme. Në konferencën kombëtare të organizuar nga Asociacioni për Edukim Shëndetësor dhe Hulimtim HERA, në partneritet me shoqatat “Së bashku më të fuqishëm”, Shoqatën për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi (ESE) dhe Iniciativën për të Drejtat e Grave nga Shuto Orizari, u theksua se qëllimet globale kërkojnë 95% të personave të diagnostikuar, ndërsa në Maqedoninë e Veriut 71,4% e personave që jetojnë me HIV e dinë statusin e tyre. Kjo do të thotë se tre nga dhjetë persona nuk e dinë se kanë HIV, gjë që e mban transmetimin aktiv dhe e vështirëson kontrollin e epidemisë.

Pjesëmarrja e shoqërisë civile në këtë sektor po rezulton të jetë thelbësore. Të dhënat tregojnë se organizatat



e shoqërisë civile zbulojnë raste të reja deri në 12 herë më me efektivitet sesa sistemi shëndetësor, falë aksesit të tyre të drejtpërdrejtë në komunitetet e cënueshme. Megjithatë, në vend të mbështetjes, mbulimi i shërbimeve

parandaluese ka rënë me një të tretën në pesë vitet e fundit për shkak të financimit të reduktuar në Programin shtetëror të HIV-it.

Ambasadori i Zvicrës, Sh.T. Kristof Somer theksoi se një qasje sistemike dhe financim i parashikueshëm janë të nevojshme për të zvogëluar infeksionet, duke theksuar mbështetjen e gjatë të Zvicrës për sektorin e shoqërisë civile maqedonase përmes “Civika mobilitas”. Ai theksoi se në luftën globale kundër HIV-it, Zvicra po ndan 64 milionë franga zvicerane për Fondin Global për Luftën kundër AIDS-it, Tuberkulozit dhe Malaries për periudhën 2026-2028.

OBSH-ja thekson se vendi duhet të vazhdojë të integrojë shërbimet në mbrojtjen shëndetësore parësore dhe të zgjerojë aksesin në PrEP (terapi parandaluese).

“Qasja e vazhdueshme në trajtim është parësore për njerëzit që jetojnë me HIV, pasi mundëson një jetë të shëndetshme dhe normale dhe parandalon transmetimin e mëtejshëm të virusit. Këtë vit, për herë të parë, u siguruan furnizime 24-mujore me ilaçe, gjë që i zvogëlon ndjeshëm rreziqet e ndërprerjes së trajtimit. Por për të ndaluar vërtet rritjen e epidemisë, duhet të investojmë në teste

dhe diagnostikim të hershëm, në mënyrë që çdo person i diagnostikuar rishtazi të mund të marrë menjëherë terapi moderne”, tha Andrei Senikh, drejtor ekzekutiv i Shoqatës për Mbështetjen e personave që jetojnë me HIV “Së bashku më të fuqishëm”.

Konferenca dhe aktivitetet e projektit “Avancimi i të drejtave shëndetësore të vajzave, grave dhe grupeve të cenushme” mbështeten nga Qeveria e Zvicrës përmes Civika mobilitas.



Raporti në hije mbi Kapitullin 27 zbulon se mjedisi ka përparuar në vend në vitet 2024 dhe 2025



Ndërsa standardet evropiane po bëhen gjithnjë e më të rrepta, progresi i Maqedonisë në mbrojtjen e mjedisit stagnon, që është përfundimi kryesor i **Raportit të katërt në Hijet mbi Kapitullin 27** i përgatitur nga koalicioni “Platforma 27”. Ky dokument është një shembull domethënës i pjesëmarrjes qytetare në procesin e integritimit evropian, ku organizatat e shoqërisë civile veprojnë si mbikëqyrës të drejtpërdrejtë dhe korrektorë të institucioneve shtetërore. Sipas gjetjeve për vitet 2024 dhe 2025, periudha shënohet nga “progresi në vend”, pasi ligjet kryesore për ujin, natyrën dhe veprimin ndaj klimës kanë ngecur në procedurë për vite me radhë pa ndonjë justifikim thelbësor për vonesën e tyre.

Situata në terren mbetet alarmante pasi ndotja e ajrit është ende shumë mbi kufijtë evropianë dhe deri në

70% të ujërave të zeza në vend shkarkohen pa asnjë trajtim. Përveç kësaj, megjithëse sistemet rajonale të menaxhimit të mbeturinave ekzistojnë në dokumentet strategjike, në praktikë qytetet shpesh përballen me grumbullim mbeturinash për shkak të mosfunksionimit të ndërmarrjeve publike. Ky trend stagnant reflektohet edhe në mbrojtjen e natyrës, ku pavarësisht presionit të fortë dhe iniciativave nga shoqëria civile, në dy vitet e fundit shteti nuk ka arritur të shpallë një zonë të vetme të re të mbrojtur, duke lënë të papërfunduara proceset për Bllatën e Belçishtës, Bllatën e Studençicës, Kozhuf dhe madje edhe rishpalljen e Parkut Kombëtar të Mavrovës.

Organizatat e shoqërisë civile të përfshira në këtë monitorim, Qendra për Ndryshime Klimatike, “Eko svest”, Shoqata Ekologjike Maqedonase (SHEM) dhe Milieukontakt Maqedoni, i bëjnë thirrje Qeverisë, Parlamentit dhe institucioneve kompetente që urgjentisht të miratojnë ligjet e bllokuara nga Kapitulli 27 dhe të sigurojnë financim të qëndrueshëm për sektorin mjedisor. Ato raportojnë se pasojat e pasivitetit institucional ndihen drejtpërdrejt nga qytetarët përmes përkeqësimit të shëndetit dhe degradimit të burimeve natyrore. Raporti është pjesë e projektit “Partneritet rajonal për zbatim më të mirë të Agjendës së gjelbër për Ballkanin Perëndimor në nivel lokal”, të cilin Qendra për Ndryshime Klimatike po e zbaton me shtatë organizata të tjera partnere, dhe me mbështetjen e Qeverisë së Zvicrës përmes Civika mobilitas.

Informacionet janë marrë nga një raport i agjencisë së lajmeve Meta.mk.

Efektet e krizës financiare dhe energjetike mbi politikat dhe qytetarët



“Si ka ndikuar kriza energjetike në cilësinë e jetës së qytetarëve maqedonas?” Kjo ishte tema kryesore e dy debateve publike të mbajtura në Shkup në shtator dhe tetor 2025. Në debate, para më shumë se 70 përfaqësuesve, u prezantuan gjetjet dhe u diskutuan rekomandimet nga një hulumtim i gjerë mbi pasojat e rritjes së shpenzimeve buxhetore nga kriza e vitit 2022.

Në çfarë lloj mjedisi veprojnë organizatat fokusi i të cilave janë çështjet gjinore?

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar ka publikuar **“Hulumtimi në fokus: Monitorimi i mjedisit mundësues për organizatat që punojnë në fushën e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave”**, i cili ofron një analizë gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në prova të kushteve në të cilat veprojnë këto organizata në Maqedoninë e Veriut.

Gjetjet tregojnë se këto organizata përballen me fragmentim dhe koordinim të dobët. Kjo kufizon mundësitë për bashkëpunim të strukturuar dhe avokim të përbashkët. Platformat e mëparshme qytetare janë kryesisht joaktive, duke lënë një boshllëk në përfaqësimin efektiv të interesave të përbashkëta.

Për më tepër, aktivistet dhe organizatat e grave të përqendruara në çështjet gjinore përballen me probleme kapaciteti, shpesh duke mos pasur mbështetje të mjaftueshme institucionale dhe profesionale për zhvillimin e lidërshipt, aftësitë menaxheriale dhe qëndrueshmërinë afatgjatë.

Sa i përket financimit, ai mbetet shumë i paqëndrueshëm, me komunat që tregojnë llogaridhënie të kufizuar për mbështetjen e shërbimeve thelbësore dhe mekanizmave qeveritarë të cenueshëm ndaj ndikimit politik. Projektet e financuara nga BE-ja dhe donatorët ndërkombëtarë shpesh përballen me pengesa për shkak të angazhimeve të dobëta ose joekzistente të bashkëfinancimit shtetëror.

Të dhënat janë alarmante: për të mbuluar kostot e shkaktuara nga kriza energjetike, shteti ka shkurtuar të paktën 220 milionë euro nga investimet kapitale të planifikuara. Në vend të kopshteve të reja, azileve të pleqve, rinovimit të objekteve shëndetësore dhe konvikteve studentore, këto fonde u ridrejtuan për të mbuluar borxhet dhe boshllëqet energjetike. Për shembull, nga 14 milionë eurot e planifikuara për rindërtimin dhe zgjerimin e objekteve shëndetësore, mezi 3.5 milionë u realizuan, ndërsa mbrojtja sociale mbeti pa projekte kyçe për kujdesin ndaj më të prekshmeve.

Situata është e ngjashme në nivel lokal. Komunat dhe Qyteti i Shkupit nuk kanë zbatuar projekte ndërtimi me vlerë 51 milion euro ose 3 miliardë denarë. Debatet nxorën në pah se planifikimi dhe ribalancimet jotransparente shpesh i “fshehin” këto shkurtime nën kategorinë e shpenzimeve kapitale, edhe pse ato nuk krijojnë vlerë të re për qytetarët.

Ky aktivitet është pjesë e projektit “Përdorimi i të dhënave të pronësisë përfituese për të zvogëluar korrupsionin”, i mbështetur nga Qeveria e Zvicrës përmes Civika mobilitas. Gjetjet theksojnë domosdoshmërinë e pjesëmarrjes vigjilente të qytetarëve në kontrollin e parave publike si e vetmja mënyrë për të siguruar shpenzime të përgjegjshme të buxhetit.

Gjetjet e hulumtimit tregojnë gjithashtu se iniciativat e udhëhequra nga gratë, programet bujqësore dhe kërkimet akademike në fushën e studimeve gjinore mbeten të pafinancuara dhe të pakta, pavarësisht rëndësisë së tyre për përfshirjen sociale dhe ekonomike. Barazia gjinore dhe të drejtat e grave shpesh marginalizohen në diskursin publik, me fushata ose përpjekje të kufizuara për të normalizuar pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje dhe në jetën qytetare.

Hulumtimi trajton si ngecjen legislative ashtu edhe të politike, si dhe kërcënimet ndaj hapësirës dhe pavarësisë qytetare, ku ndërhyrja politike në financim, konfliktet e interesit dhe instrumentalizimi i iniciativave qytetare për qëllime partiake njihen si elementë që dëmtojnë besueshmërinë dhe pavarësinë e shoqërisë civile.

Të gjitha përfundimet nga kjo analizë janë përkthyer në rekomandime që mund t’i përgjigjen sfidave aktuale.

Të dhënat për hulumtimin u mblodhën gjatë vitit 2025 përmes desk hulumtimit, intervistave gjysmë të strukturuar me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, aktivistë dhe palë të interesuara institucionale, si dhe përmes analizës së bazuar në raste.

U promovua analiza krahasuese dhe rekomandime në luftën kundër padive SLAPP



Si pjesë e Ditëve të kompetencës mediatike, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA) mbajti një aktivitet kushtuar forcimit të qëndrueshmërisë së komunitetit mediatik ndaj presioneve ligjore. Fokusi ishte në paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike, të njohura si SLAPP, të cilat përdoren gjithnjë e më shumë si një mjet për të heshtur gazetarët. Eventu është një shembull i pjesëmarrjes së qytetarëve, ku organizatat dhe ekspertët e gazetarëve ndikojnë drejtpërdrejt në krijimin e mekanizmave ligjorë për mbrojtjen e interesit publik. Pjesa qendrore e eventit ishte prezantimi i **Analizës krahasuese të trajtimit të SLAPP** në vendet e BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, të përgatitur nga Zharko Aleksov dhe Zharko Haxhi-Zafirov. Analiza tregon boshllëqe serioze në rregulloren maqedonase, në veçanti mungesën e mekanizmave për hedhjen poshtë të parakohshme të

padive abuzive, gjë që i lë gazetarët të ekspozuar ndaj presionit afatgjatë financiar dhe psikologjik. Autorët rekomanduan një sërë masash ligjore dhe institucionale që do të mundësonin reagim më të shpejtë të gjykatave dhe parandalim më të mirë të rasteve të tilla.

Kryetari i SHGM-së, Mlladen Çadikovski dhe drejtori ekzekutiv Dragan Sekullovski, thanë se lufta kundër SLAPP-it është thelbësore për pavarësinë e medias, pasi presionet shpesh vijnë nga qendra të fuqishme politike dhe ekonomike. Sekullovski theksoi se nevojitet koordinim urgjent midis institucioneve për t'u harmonizuar me Direktivën e re Evropiane për SLAPP-in. Mbështetje për këtë proces shprehu edhe Leona Kiçeç, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë, e cila e theksoi gatishmërinë për dialog mbi reformat e ardhshme. Sekretari i përgjithshëm i Federatës Evropiane të Gazetarëve, Rikardo Gutierrez, theksoi gjithashtu rëndësinë e solidaritetit dhe një qasje të koordinuar të organizatave të gazetarëve në nivel evropian.

Zvogëlimi dhe parandalimi i padive SLAPP kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm ndër-institucional, përmirësime të konsiderueshme legislative dhe mekanizma praktikë për të mbështetur gazetarët që i nënshtrohen presioneve ligjore.

Publikimi u prodhua si pjesë e projektit “Trajnim - Akademia e gazetarëve dhe punonjësve të medias, T-AJM”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), në partneritet me Iniciativën për Perspektiva Evropiane (IPE) dhe Federatën Evropiane të Gazetarëve (EFJ).

ANGAZHIMI QYTETAR

Të rinjtë nga Gostivari dhe Shtipi zbuluan vlerat e vullnetarizmit

Dita Botërore e Vullnetarizmit, 5 Dhjetori, u shënuar nga aktivizmi rinor, përmes ngjarjeve të organizuara në Qendrat e Burimeve në Gostivar dhe Shtip. Me mesazhin e përbashkët se vullnetarizmi e transformon një të ri në një qytetar aktiv, dhjetëra të rinj debatuan mbi fuqinë e ndihmës pa prituri asgjë në këmbim. Në Gostivar, fokusi ishte në njohjen e formave të ndryshme të vullnetarizmit, nga ndihma humanitare direkte në komunitet deri te avokimi aktiv dhe filantropia. Pjesëmarrësit analizuan ndryshimet midis vullnetarizmit dhe punës praktike,

duke arritur në përfundimin se angazhimi vullnetar është shkolla më e mirë për zhvillimin e aftësive për të zgjidhur sfidat lokale.

Ky entuziazëm për ndërtimin e komunitetit u përhap edhe në Shtip, ku mbi 70 pjesëmarrës diskutuan nëse vlerat e vullnetarizmit po u kalohen me sukses brezave të ardhshëm. Ndërsa në Gostivar mësuan rreth kornizës teorike të aktivizmit, në Shtip nxënësit e SHFK “Dimitar Vlahov” demonstruan praktikisht angazhimin e tyre duke

përgatitur kartolina urimi krijuese për vullnetarët më të vjetër si shenjë mirënjohjeje. Dejan Andov nga Unioni për Punë Rinore theksoi se “vullnetarizmi është një akt i vendosjes së standardeve më të larta për mënyrën se si duhet të sillen të gjithë njerëzit në shoqërinë tonë, një akt që tregon dashuri për komunitetin”.

Për Andovin, vullnetarizmi është forma më e pastër e pjesëmarrjes qytetare dhe një nxitës i ndryshimeve pozitive. Në të dy qytetet, përfundimi i të rinjve ishte identik: nevojitet më shumë mbështetje nga institucionet dhe më shumë shembuj pozitivë që do t'i frymëzojnë brezat e rinj të jenë të guximshëm dhe të krijojnë historitë e tyre të suksesit. Këto aktivitete janë pjesë e projektit “Mbështetja e BE-së për Qendrën e Burimeve Qytetare -

Faza 2” e financuar nga Bashkimi Evropian. Ato u zbatuan nga Fondacioni Kombëtar për Zhvillimin e Shoqërisë Civile “Qendra e Burimeve Qytetare”, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Asociacioni për Iniciativa Demokratike Gostivar dhe Media Plus Shtip.

200 vullnetarë të Borenkës mbollën rreth 5,000 fidanë në Ditën Botërore të Vullnetarizmit

5 Dhjetori – Dita Botërore e Vullnetarizmit dhe Dita Botërore e Tokës – është një datë që na kujton se kujdesi për tokën dhe komunitetin fillon nga vetja jonë. Pas tetë aksioneve vjeshtore të zbatuara me sukses, aksioni i nëntë vullnetar i pyllëzimit - Borenka, këtë sezon u zbatua pranë Demir Kapisë, në lokacionin Pylli i Goces. Mbi 200 skautë të rinj vullnetarë u bashkuan në terren, përfshirë anëtarë të njësitit të skautëve “Dimitar Vllahov” nga Velesi, vullnetarë nga Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, si dhe anëtarë të Armatës së Republikës së Maqedonisë. Së bashku me ekipet e ekspertëve të NP “Pyjet kombëtare”, ata e shënuan festën duke krijuar jetë të re në zonat e djegura dhe të degraduara në të gjithë vendin.

Përmes punës së përbashkët të Shoqatës së Vëzhguesve të Maqedonisë dhe “Pyjeve kombëtare”, u mbollën afërsisht 40,000 fidanë në nëntë lokacione në të gjithë vendin. Ky rezultat, me një mesatare prej 5,000 fidanësh për veprim, konfirmon edhe një herë fuqinë e vullnetarizmit dhe koordinimit të shkëlqyer në terren.

Pyllëzimi kryhet nga Pyjet kombëtare dhe mbështetet nëpërmjet bashkëpunimit me projektin GEF6 - Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës - një projekt i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin - UN Environment. Programi (UNEP).



Investimi si shkathtësi kryesore financiare për të rinjtë

Në një kohë kur të rinjtë përballen gjithnjë e më shumë me nevojën për të menaxhuar në mënyrë të pavarur me të ardhurat e tyre, edukimi financiar po bëhet një shkathtësi kyçe për përparim. Për këtë qëllim, në ambientet e “Up Hub” në Strumicë, u mbajt një ligjëratë edukative kushtuar investimit në letrat me vlerë dhe menaxhimit të zgjuar të financave personale. Eventi ofroi një hapësirë të hapur ku të rinjtë u njohën me përvoja reale dhe hapa praktike për të marrë vendime të informuara financiare.

Ligjëruesi Ivan Ivanovski, përmes një diskutimi interaktiv, tha se investimi nuk është një aftësi që mund të mësohet brenda natës, por një proces që kërkon njohuri, durim dhe disiplinë. “Liria financiare është rezultat i një qëndrimi të përgjegjshëm ndaj financave të veta”, theksoi ai, duke i inkurajuar pjesëmarrësit të mendojnë në plan afatgjatë. Ky aktivitet është pjesë e projektit “Rrjeti rinor për edukim financiar në Juglindje”, i mbështetur nga Qeveria e Zvicrës përmes Civika mobilitas, të zbatuar nga shoqatat “Promo Idea”, “Novus” nga Strumica, si dhe “Kruna Plus” nga Radovishi. Përmes nismave të tilla, të rinjtë në rajonin Juglindor marrin vegla të fuqishme për informacion në kohë, duke ndërtuar themelet për një të ardhme më të sigurt dhe financiarisht të pavarur.



Rreth krenimit të Javës së fëmijëve në Tetovë



Me rastin e Javës së fëmijëve, e cila festohet çdo vit në javën e parë të tetorit, Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ) i theksoi një nga mesazhet më të rëndësishme për çdo fëmijë - se me të drejtat vijnë përgjegjësitë dhe se të mësuarit dhe respekti nuk kanë kufij gjuhe, etnie apo aftësie.

Ekipi i QMEQ e vizitoi Shkollën Fillore “Bratstvo Migjeni” në Drenoc të Tetovës, ku u mbajt një orë e përbashkët ndërkulturore e shkencave kompjuterike, në të cilën

morën pjesë nxënës që i ndjekin mësimet në gjuhën maqedonase dhe shqipe si gjuhë mësimore. Nën udhëheqjen e dy mësimeve, ata punuan “krah për krah”, duke përdorur mjete digjitale për të eksploruar tema që lidhen me barazinë, empatinë dhe përgjegjësinë. Nga ky aktivitet, nxënësit duhej të mësonin se çdo fëmijë ka të drejtë për arsim dhe siguri, por edhe detyrimin për t'u sjellë me mirësi dhe respekt ndaj të tjerëve.

Aktiviteti është pjesë e projektit “Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore”, i zbatuar nga Shoqata për Teknologji Asistive “Hapni dritaret” në bashkëpunim me Qendrën Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ), me mbështetje financiare nga Fondacioni për Fëmijë “Pestalocci”.

“Ne mbetemi të përkushtuar për të krijuar mjedisë gjithëpërfshirëse në të cilat të gjithë fëmijët, pavarësisht nga prejardhja apo aftësitë e tyre, mund të arrijnë potencialin e tyre të plotë dhe të ndihen të vlerësuar si anëtarë të barabartë të komunitetit”, theksuan përfaqësuesit e QMEQ, duke kujtuar se përgjegjësia për hapësira të tilla u takon mësimeve, prindërve dhe të gjithë komunitetit

Diskutim mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara



Me rastin e Ditës ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara - 3 dhjetor, në Shkup u mbajt një diskutim me temën “Prezantimi i Konventës për të drejtat e personave me atësi të kufizuara dhe roli i Avokatit të Popullit”. Ngjarja, e organizuar nga Avokati i Popullit dhe Asociaconi për Edukim Shëndetësor dhe Hulumentim (HERA), mundësoi një dialog të drejtpërdrejtë midis institucioneve, personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre rreth sfidave reale me të cilat përballen në jetën e përditshme.

Vaska Bajramovska-Mustafa, zëvendës Avokatja e Popullit, kujtoi se megjithëse shteti e ratifikoi Konventën në vitin 2011, zbatimi i saj praktik është ende larg përfundimit. Diskutimi nxori në pah problemet kryesore sistematike: aksesin e vështirë në vlerësimin e aftësisë së kufizuar funksionale, pagesat e parregullta të asistentëve personalë dhe ofruesve të tjerë të ndihmës, mungesën e asistentëve arsimorë në shkolla dhe mungesën fizike të aksesit në institucionet e mbrojtjes shëndetësore.

Mesazhi kryesor nga takimi ishte se ndryshimi fillon me dëgjimin e nevojave të qytetarëve. Pjesëmarrësit kërkuar forcimin e marrëdhënies midis Avokatit të Popullit dhe personave me aftësi të kufizuara, si dhe kompetenca më të mëdha të këtij institucioni për zgjidhjen më të shpejtë të rasteve specifike. “Konventa nuk është vetëm një detyrim ndërkombëtar, por edhe bazë për një shoqëri gjithëpërfshirëse”, thanë organizatorët, duke theksuar se angazhimi qytetar është çelësi për të ushtruar presion mbi institucionet derisa të sigurohet një jetë dinjitoze për të gjithë.

Informacioni rreth kësaj ngjarjeje është marrë nga një raportim i Agjencisë Informative Mediatike (MIA).



Është promovuar platforma për monitorimin e femicideve



Me rastin e Ditës ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe në kuadër të fushatës “16 Ditë aktivizëm kundër dhunës me bazë gjinore”, Misioni i OSBE-së në Shkup

promovoi Platformën e monitorimit të femicideve (“Femicide Watch”). Ky observator kombëtar i parë i këtij lloji synon të identifikojë boshllëqet sistematike dhe të mundësojë veprime të hershme dhe të koordinuara për të parandaluar femicidin. Në këtë aktivitet, përpara zyrtarëve të lartë qeveritarë, gjyqtarëve, prokurorëve dhe organizatave të shoqërisë civile, Ambasadori Kilian Wahl (Kilian Wahl) tha se femicidi mund të parandalohet vetëm me përgjegjësi të përbashkët, pasi funksionimi i izoluar i institucioneve i lë rreziqet pa u vënë re. “Parandalimi i vërtetë fillon me veprim të hershëm dhe përgjegjësi të përbashkët”, tha ambasadori Wahl.

Kontributi kryesor i sektorit të shoqërisë civile në këtë proces u theksua nga Uranija Pirovska, drejtoreshë ekzekutive e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Ajo paralajmëroi për dështime serioze institucionale në rastet kur viktimat më parë kishin raportuar dhunë, por mungonte mbrojtja e duhur. Sipas Pirovskës, duke vendosur standarde për mbledhjen e të dhënave dhe llogaridhënien ndërsektoriale, Platforma do të forcojë ndjeshëm kapacitetet për parandalimin dhe reagimin ndaj femicidit. “Femicide Watch” nuk është vetëm një vegël statistikore, por një mekanizëm që duhet të transformojë mënyrën se si shteti i mbron gratë, duke i përkthyer analizat në politika konkrete që do të shpëtojnë jetë.



“Luludi”: Të drejtat e njeriut nuk janë privilegj

Festimi i 10 dhjetorit - Ditës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, këtë vit shërbeu si një kujtesë e fuqishme se e drejta për një jetë pa dhunë, diskriminim dhe frikë duhet të jetë realitet për çdo person, me theks të veçantë tek gratë dhe vajzat rome të cilat shpesh mbeten në margjinat e sistemit.

Shoqata Rome për Gratë dhe të Rinjtë “Luludi”, e cila vepron çdo ditë në terren përmes edukimit dhe ofrimit të shërbimeve të ndjeshme ndaj kulturës, dërgoi një thirrje të qartë për institucionet që të forcojnë urgjentisht mekanizmat e mbrojtjes. Mesazhi i tyre është i qartë: institucionet më në fund duhet të ofrojnë mbrojtje në kohë, efikase dhe jo-diskriminuese, të mbështetur nga financimi i vazhdueshëm i shërbimeve të specializuara që do t’u përgjigjen nevojave specifike të grave rome dhe grupeve të tjera të marginalizuara.

Për ndryshim të vërtetë, Shoqata këmbëngul në transparencë të plotë dhe aksesueshmëri të informacionit, i cili duhet të jetë i disponueshëm në një gjuhë dhe format të kuptueshëm për komunitetin, përfshirë edhe në gjuhën rome. Ky proces reforme nuk duhet të ndodhë pa përfshirjen e drejtpërdrejtë të organizatave të grave rome në krijimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave për mbrojtje nga dhuna. Vetëm nëpërmjet mbledhjes së rregullt të të dhënave dhe analizës së tyre të plotë ndërsektoriale - e cila merr parasysh gjininë, etninë, moshën dhe statusin socio-ekonomik, shteti mund të krijojë masa të bazuara në prova reale, jo në supozime. “Ne besojmë në një sistem ku institucionet ofrojnë mbrojtje në kohë dhe efikase, ndërsa komuniteti nuk është një dëshmitar i heshtur, por një aleat që tregon empati, solidaritet dhe mbështetje.



10 ДЕКЕМВРИ - МЕЃУНАРОДЕН ДЕН
НА ЧОВЕКОВИТЕ ПРАВА

**ЧОВЕКОВИТЕ ПРАВА НЕ СЕ ПРИВИЛЕГИЈА.
ТИЕ ВАЖАТ ЗА СИТЕ - СЕКОГАШ И СЕКАДЕ!**



**10 DECEMBER - INTERNATIONAL HUMAN
RIGHT'S DAY**

Të drejtat e njeriut nuk janë privilegj. Ato vlejné për të gjithë - gjithmonë dhe kudo”, thanë nga ORGR “Luludi”. Shoqata e romëve mbetet e hapur për bashkëpunim dhe nisma të përbashkëta që do të kontribuojnë në mbrojtje më të mirë dhe realizim të plotë të të drejtave të grave dhe vajzave rome.

Debat dhe trajnim mbi temën “Barazia dhe mosdiskriminimi”


Nën organizimin e shoqatave “Aksios” dhe “ZETA - Organizata për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Drejtësi”, në Shkup u mbajt një debat dhe trajnim me temë “Barazia dhe mosdiskriminimi”, si pjesë e projektit “Barazia gjithëpërfshirëse”. Qëllimi kryesor i kësaj iniciative është forcimi i kapaciteteve të autoriteteve lokale dhe organizatave të shoqërisë civile me theks në shoqatat e personave me aftësi të kufizuara, me fokus të veçantë në barazi, mosdiskriminim dhe barazi gjithëpërfshirëse.

Trajnuesit Elena Koçoska dhe Julijana Klimoska shpjeguan format e ndryshme të barazisë përmes një dialogu interaktiv, duke theksuar se vetëm barazia formale para ligjit nuk është e mjaftueshme nëse grupe të caktuara, për shkak të karakteristikave të tyre të identitetit, mbeten të përjashtuara nga rrjedhat shoqërore. Barazia gjithëpërfshirëse, si forma më e lartë, nënkupton pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrje. “Parimi i përfshirjes

thotë se e drejta i përket qytetarit dhe ai duhet të vendosë se si ta përdorë atë”, theksoi Koçoska, duke theksuar se qytetarëve duhet t’u kërkohet se çfarë u nevojitet edhe

në fazën e planifikimit të politikave lokale. Një pjesë e veçantë e debatit iu kushtua diskriminimit dhe fuqisë së gjuhës, ku u theksua se emrat e papërshtatshëm dhe fyes për personat me aftësi të kufizuara i marginalizojnë më tej këta qytetarë. I tillë është emri “i paaftë”, si dhe “invalid” dhe të gjitha derivatet e tij. Mesazhi i pjesëmarrësve ishte i qartë: “Ne nuk jemi as të pavlefshëm dhe as të padobishëm” - dinjiteti dhe mundësitë e barabarta duhet të jenë themeli i çdo shoqërie demokratike që përpiket për drejtësi të vërtetë.

Informacioni rreth kësaj ngjarjeje është marrë nga një raportim i Agjencisë Informative Mediatike (MIA).



Ambasadorë të rinj ekologjikë në Prilep - Aktivistë lokalë për mbrojtje të drejtpërdrejtë të mjedisit

Përmes një trajnimi intensiv tre-ditor të mbajtur në tetor, Prilepi fitoi bërthamën e parë të eko-ambasadorëve lokalë, të gatshëm të vepronë si një lidhje kyçe midis qytetarëve dhe autoriteteve lokale. Kjo iniciativë nga shoqata “Stanica PET” nga Prilepi, i pajisi aktivistët me mjete praktike për avokim qytetar, kuptimin e politikave mjedisore dhe organizimin e veprimeve publike. Në vend të vetëm njohurive teorike, pjesëmarrësit punuan mbi shembuj realë, duke analizuar Planin lokal të veprimit mjedisor të Prilepit dhe duke zbuluar problemet më urgjente në komunitet - nga mosfunksionimi i komuniteteve lokale dhe mungesa e zonave të gjelbra, deri te çështja e përzgjedhjes së mbeturinave dhe nevoja për shpejtësi më të madhe të inspektorëve komunalë. Trajnimi jo vetëm që krijoi individë të arsimuar, por edhe një rrjet të ri udhëheqësish, të cilët përmes ndërmjetësimit të drejtpërdrejtë, do të kërkojnë llogaridhënie dhe transparencë nga institucionet. Duke identifikuar sfidat specifike lokale dhe duke krijuar zgjidhje për praktika më të mira mjedisore, këta eko-ambasadorë bëhen një forcë lëvizëse për një komunitet më të gjelbër dhe më aktiv.

Aktiviteti është pjesë e projektit “Eko Iniciativa: qytetarët dhe pushteti lokal në veprim për të mbrojtur mjedisin!”, i mbështetur nga Bashkimi Evropian, i cili konfirmon edhe një herë se ndryshimi i vërtetë fillon me mobilizimin në nivel lokal dhe bashkëpunimin midis qytetarëve dhe vendimmarrësve.



“Radari disinfo” i Fondacionit Metamorfozis u prezantua në Forumin e paqes në Paris 2025

Inovacioni maqedonas për përballimin e dezinformimit, “Radari disinfo” i Fondacionit Metamorfozis, ishte ndër 30 zgjidhjet globale të prezantuara në Forumin e paqes në Paris 2025, i cili u zhvillua më 29 dhe 30 tetor. Përzgjedhja në një konkurrencë të fortë globale është një konfirmim i lidershit të gjatë të Metamorfozis në mbrojtjen e vlerave demokratike dhe integritetit të medias në Ballkanin Perëndimor.

Në vend që thjesht të demaskojë në mënyrë reaktive lajmet e rreme, “Radari disinfo” funksionon si një sistem paralajmërimi i hershëm që parashikon narrativat e dëmshme përpara se ato të shkaktojnë tensione ose polarizim etnik. Duke kombinuar ekspertizën njerëzore me analizën e asistuar nga inteligjenca artificiale, ky sistem pajis median dhe shoqërinë civile me informacion në kohë për të vepruar në mënyrë proaktive. “Radari disinfo” doli nga puna e projektit rajonal “Qendra kundër dezinformimit për Ballkanin Perëndimor” e mbështetur nga Mbretëria e Holandës. Lançimi i tij në Forum konfirmon ndikimin rajonal të Fondacionit dhe hap mundësi të reja për bashkëpunim me partnerë globalë dhe mentorim përmes Programit Scaling Up (SCUP).

Ky sukses është provë se iniciativat vendase qytetare jo vetëm që po ndjekin trendet globale, por gjithashtu po krijojnë në mënyrë aktive zgjidhje inovative me ndikim global.



“Suport Koçani” e realizoi dërgesën e katërt të veshjeve kompresive, me vlerë 452.537 denarë, për njerëzit e prekur nga zjarri në Koçan

Një dërgesë e re me veshje kompresive, me vlerë mbi 450,000 denarë, është dorëzuar tashmë në Spitalin e përgjithshëm në Koçan, duke u ofruar pacientëve mbështetje thelbësore në procesin e rehabilitimit të tyre afatgjatë. Donacioni përfshin 44 veshje të personalizuar të bëra sipas porosisë për 14 pacientë dhe është rezultat i mbështetjes masive nga qytetarët dhe komuniteti i biznesit. Fondet u siguruan ekskluzivisht përmes kontributeve vullnetare nga vendi dhe jashtë vendit, gjë që edhe një herë konfirmon solidaritetin e fortë shoqëror kur është më e nevojshme. “Mbështetja që marrim nga komuniteti na lejon të ndihmojmë vazhdimisht të prekurit dhe të sigurojmë pajisje mjekësore në kohë”, theksojnë anëtarët e Iniciativës. Ata theksuan se mbeten plotësisht të përkushtuar ndaj transparencës dhe kujdesit të vazhdueshëm për të lënduarit deri në shërimin e tyre të plotë.



